



GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
COUR EUROPEENNE DES DROITS DE L'HOMME

Deklaratë për Shtyp e lëshuar nga
Regjistruesi i Gjykatës
ECHR 054 (2011)
21.06.2011

**Dy djemve rusë që banonin në Bullgari nuk duhet t'u ishte kërkuar të paguanin
tarifat shkollore për arsimin e tyre dytësor**

Në vendimin e sotëm të Dhomës në çështjen [Anatoliy Ponomaryov dhe Vitaliy Ponomaryov kundër Bullgarisë](#) (ankimi nr. 5335/05), i cili nuk ka marrë formë të prerë¹, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut vendosi unanimisht se ka patur:

Një shkelje të Nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) **në lidhje me** Nenin 2 të Protokollit Nr. 1 të **Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut**.

Çështja lidhet me kërkesën se dy djem rusë që banojnë në Bullgari me nënën e tyre, e cila ishte martuar me një shtetas bullgar, paguanë tarifa shkollore për arsimin e tyre dytësor, në dallim nga shtetas dhe të huaj bullgarë me leje vendbanimi të përhershëm.

Faktet kryesore

Ankuesit, Anatoliy dhe Vitaliy Ponomaryovy, janë dy shtetas rusë që kanë lindur përkatësisht në vitin 1986 dhe 1988 në Republikën Socialiste Sovjetike të Kazakistanit dhe banojnë në Pazardzhik, Bullgari.

Pas divorcit të prindërve, Anatoliy dhe Vitaliy qëndruan me nënën e tyre në Bullgari ku ajo u martua me një shtetas bullgar dhe ku familja u vendos në vitin 1994. Nëna mori leje vendbanimi të përhershëm në bazë të martesës së saj dhe Anatoliy dhe Vitaliy kishin të drejtë të banonin në Bullgari për shkak të nënës së tyre. Djemtë ndiqnin shkollat në nivelin parësor dhe dytësor në Pazardzhik dhe flisnin rrjedhshëm bullgarisht.

Në vitin 2005, kur Anatoliy ishte në vitin e tij të fundit të shkollës së mesme dhe Vitaliy në vitin e tij të parafundit, u urdhëruan të paguanin tarifa shkollore në shuma përkatësisht 800 Euro (EURO) dhe 2,600 EURO. Nëse nuk paguanin, u ishte thënë se nuk do të mund të shkonin në shkollë dhe nuk do t'u jepej dëftesa për përfundimin e vitit shkollor. Autoritetet shkollore i arsyetuan urdhrat me një vendim ministerial të vitit 2004 dhe me legjislacionin përkatës bullgar, Ligjin mbi Arsimin të vitit 1991, i cili përcaktonte se të huajt që nuk kishin leje vendbanimi të përhershëm do të duhet të paguanin tarifa për arsimin e tyre dytësor.

Anatoliy dhe Vitaliy apeluan pa sukses para gjykatave.

¹ Sipas Neneve 43 dhe 44 të Konventës, ky gjykim i Dhomës nuk është i formës së prerë. Gjatë periudhës tre mujore pas dhënies së tij, çdo palë mund të kërkojë që çështja t'i kalojë Dhomës së Madhe të Gjykatës. Nëse bëhet një kërkesë e tillë, një trup prej pesë gjyqtarësh shqyrton nëse çështja meriton shqyrtim të mëtejshëm. Në këtë rast, Dhoma e Madhe do të dëgjojë rastin dhe do të japë një gjykim përfundimtar. Nëse kërkesa për referim refuzohet, gjykimi i Dhomës do të jepet në formë të prerë në atë ditë.

Pasi një aktgjykim bëhet i formës së prerë, ai i transmetohet Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të tij. Informacione të mëtejshme në lidhje me procesin e ekzekutimit mund të gjeni këtu: www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution

Sipas gjasave, shkollat e tyre praktikisht nuk i pengonin të merrnin pjesë në orët mësimore por diploma e shkollës të nivelit dytësor të Anatolijit u lëshua rreth dy vjet pas afatit të kërkueshëm.

Deklaratë për Shtyp

Ankimet, procedura dhe përbërja e Gjykatës

Duke u mbështetur në Nenin 14 në lidhje me Nenin 2 të Protokollit Nr. 1 të Konventës, ankuesit u ankuan se ishin diskriminuar pasi në dallim nga shtetasit dhe të huajt bullgarë që kanë leje vendbanimi të përhershëm, atyre u ishte kërkuar të paguanin tarifa për të qenë pjesë e arsimit të tyre dytësor.

Ankimi u depozitua pranë Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në datën 8 shkurt 2005.

Vendimi u dha nga një Dhomë me shtatë pjesëmarrës me përbërjen e mëposhtme:

Nicolas **Bratza** (Mbretëria e Bashkuar), *Kryetar*,
Lech **Garlicki** (Poloni),
Ljiljana **Mijovic** (Bosnje dhe Hercegovinë),
Sverre Erik **Jebens** (Norvegji),
Zdravka **Kalaydjieva** (Bullgari),
Nebojsa **Vucinic** (Mali i Zi),
Vincent A. **de Gaetano** (Maltë), *Gjyqtarë*,

Dhe gjithashtu Lawrence Early, *Regjistruesi i Seksionit*.

Vendimi i Gjykatës për
Zbatueshmërinë e Nenit 14

Gjykata vërejti se ndalimi i diskriminimit sipas Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut zbatohet për të gjitha të drejtat që Shteti kishte vendosur të jepte sipas Konventës dhe Protokolleve të Saj. Kur Shtetet subvencionojnë institucione të veçanta arsimore, ata duhet të garantonin akses efektiv tek ta. Meqë kjo ishte pjesë integrale e të drejtës për arsim sipas Nenit 2 të Protokollit Nr. 1, u zbatua Neni 14.

Për shkak se Anatolij dhe Vitaliy kishin qenë nxënës të shkollës në nivelin dytësor të cilët, në dallim nga këta nxënës të tjerë, duhet të paguanin tarifa studimi, ata ishin trajtuar haptazi në mënyrë më pak të favorshme sesa të tjerët në një situatë të ngjashme.

Ndalimi i diskriminimit

Gjykata theksoi se roli i saj nuk ishte të vendoste nëse Shteteve u lejohej të caktonin tarifa për arsimin por vetëm kur një Shtet kishte vendosur vullnetarisht të ofronte arsim falas, ajo mund të përjashtonte një grup njerëzish pa justifikim.

Ishte e vërtetë se arsimi ishte një veprimtari e kushtueshme dhe komplekse. Meqë burimet e Shtetit ishin pashmangshmërisht të kufizuara, Shtetet duhet të vendoste një ekuilibër midis nevojave arsimore të njerëzve dhe kapacitetit të kufizuar të Shteteve për përmbushjen e këtyre nevojave.

Në të njëjtën kohë, arsimi gëzonte mbrojtje të drejtpërdrejtë sipas Konventës, si pjesë e Protokollit Nr. 1. Ishte jo vetëm e dobishme për individët por edhe për shoqërinë në tërësi që të integronte pakicat nëse do të ishte pluraliste dhe demokratike.

Në përgjithësi, Shtetet ishin të lira të kërkonin tarifa për arsimin universitar që ishte opsional. Nga ana tjetër, ato duhet të garantonin arsim parësor të aksesueshëm që ofronte konceptet bazë të shkrimit e leximit dhe matematikës. Duke patur parasysh faktin se një numër gjithnjë e më i madh vendesh po përparojnë drejt konceptit të shoqërisë “të bazuar në dije” në praktikë, Gjykata vërejtë se arsimi dytësor ishte i një rëndësie gjithnjë e më të madhe për zhvillimin e individit dhe shoqërisë në tërësi.

Kjo deklaratë për shtyp është një dokument i përgatitur nga Zyra e Regjistrimit. Ajo nuk është detyruese për Gjykatën.

Vendimet, gjykimet dhe informacione të tjera rreth Gjykatës mund të gjenden në [faqen e saj të internetit](#). Për të marrë deklaratat për shtyp të Gjykatës, ju lutem abonohuni në Court's RSS feeds.

Personat e Kontaktit të Shtypit

echrpess@echr.coe.int | tel: +33 3 90 21 42 08

Kristina Pencheva-Malinowski (tel: + 33 3 88 41 35 70)

Emma Hellyer (tel: + 33 3 90 21 42 15)

Tracey Turner-Tretz (tel: + 33 3 88 41 35 30)

Frederic Dolt (tel: + 33 3 90 21 53 39)

Nina Salomon (tel: + 33 3 90 21 49 79)

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut u krijua në Strasburg nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës në vitin 1959 për trajtimin e shkeljeve të pretenduara të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut të vitit 1950.